

Nr. i serisë:
Kodi:

KONTRATË INDIVIDUALE PËR ANËTARËSIMIN NË FONDIN E PENSIONIT PRIVAT ME PJËSMARRJE TË HAPUR SIGAL PRO PENSION

Mbështetur në nenin 62 dhe 97 të ligjit nr.76/2023, "Për Fondet e Pensionit Privat", rregulloreve të AMF-së si dhe akteve nënligjore të zbatueshme, sot më datë _____, në _____ nënshkruhet kjo kontratë midis palëve si më poshtë:

SHOQËRIA ADMINISTRUESE

SIGAL UNIQA INVEST – Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a. (në vijim Shoqëria Administruese) person juridik i themeluar në datë 21.01.2006 dhe i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit më datë 31.01.2006 me NUIS K61423001P, me seli në Rr. "Ukraina e Lirë", pas Kullave Binjake, midis Ambasadës së Kosovës dhe asaj Zvicerane (Pallati i Ri Teknoprojekt), Tiranë, me licencë nr. 2, datë 28.04.2022 lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, e cila administron Fondin e Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL PRO PENSION i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me Vendim Bordi nr. 251, datë 20.12.2022, përfaqësuar nga Z. ELVIS PONARI, Administrator. Fondi i Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL PRO PENSION është fond pensioni privat me pjesëmarrje të hapur dhe me kontribute të përcaktuara në Republikën e Shqipërisë. Monedha bazë e Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL PRO PENSION është Lekë.

Dhe

ANËTARI

Emri	Atësia	Mbiemri	Datëlindja	Gjinia
Adresa	Vendbanimi i përhershëm dhe/ose i përkohshëm	Telefon/E-mail	Vendlindja	Shtetësia
Profesioni	Numri personal (NID) Nr. letërnjoftimit / Nr. pasaporte / NPPS			

i cili kërkon të anëtarësohet në Fondin e Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL PRO PENSION (në vijim Fondi) , për të marrë pjesë në fondin e pensionit privat me kontribute të përcaktuara.

Shuma e kontributit në këtë fond është _____ lekë, me frekuencë _____, për një afat _____

Burimi i të ardhurave _____

Konfirmoj, se informacioni i dhënë më lartë është i saktë.

Deklaroj se kam marrë një kopje të kësaj kontrate. Konfirmoj se kam kuptuar kushtet e kontratës të cilat i pranoj dhe angazhohem për zbatim të tyre.

Deklaroj se kam marrë një kopje të prospektit. Konfirmoj se kam kuptuar dhe pranoj përmbajtjen e Prospektit të Fondit dhe konfirmoj se kam marrë përsipër rrezikun e mundshëm të investimit si dhe tarifat që aplikohen.

Kuptoj se të dhënat e mia personale të deklaruar në këtë kontratë/ose në çdo dokument tjetër të nënshkruar apo deklaruar, janë të dhëna të detyrueshme, të cilat do të përpunohen nga shoqëria administruese me standardet me të larta të sigurisë si dhe konform parashikimeve ligjore në fuqi, vetëm për qëllimin e ofrimit të produkteve dhe/ose për të përmbushur një detyrim ligjor që shoqëria administruese mund të ketë bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në Republikën e Shqipërisë. Kuptoj se mbetet detyrim i imi të përditësoj këto të dhëna, sa herë që do të ndryshohen.

Autorizoj Shoqërinë Administruese për përpunimin e të dhënave personale, në përputhje me ligjin nr. 9887, date 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale". Me përpunim të dhënash në kontekstin e këtij autorizimi bazuar në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008, kupto "grumbullimin, regjistrimin, ruajtjen, renditjen, përshtatjen, ndreqjen, këshillimin, shfrytëzimin, përdorimin, bllokimin, fshirjen ose shkatërrimin, transmetimin" etj.

Autorizoj Shoqërinë Administruese për deklarimin e të dhënave të mia personale, pranë institucioneve përkatëse të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

ANËTARI

SIGAL UNIQA INVEST– Shoqëria Administruese
e Fondeve të Pensionit Privat dhe
Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive sh.a.
ADMINISTRATOR
ELVIS PONARI

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Në zbatim të nenit 62 dhe 97 të ligjit nr.76/2023, "Për Fondet e Pensionit Privat" (në vijim Ligji), rregulloreve të AMF-së si dhe akteve të tjera nënligjore të zbatueshme, palët e mësipërme bien dakord për kushtet e anëtarësimit në një fond pensioni privat me pjesëmarrje të hapur, me kontribute të përcaktuara.

Neni 1 Objekti dhe Qëllimi i Kontratës

- Objekt i kësaj kontrate është përcaktimi i të drejtave dhe detyrimeve të anëtarit të Fondit të Pensionit Privat me Pjesëmarrje të Hapur SIGAL PRO PENSION (në vijim "Fondi") dhe Shoqërisë Administruese për anëtarësimin e tij në Fond.
- Qëllimi i lidhjes së kësaj kontrate është anëtarësimi në Fond me qëllim përfitim pensioni privat në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 2 Anëtarësimi në Fond

- Në këtë Fond mund të anëtarësohet çdo person, i cili me pëlqimin e tij (ose të përfaqësuesit të tij ligjor) bëhet anëtar i fondit dhe lidh këtë kontratë anëtarësimi me Shoqërinë Administruese për të përfituar shërbimet e fondit të pensionit.
- Pjesë përbërëse e kësaj kontrate është formulari standard i aplikimit, i cili përmban të dhënat personale të anëtarit. Duke e nënshkruar këtë formular anëtar i pranohet kushtet e kontratës, si dhe deklaron nën përgjegjësinë e tij se është njohur dhe ka kuptuar plotësisht prospektin e Shoqërisë Administruese.
- Për çdo anëtar të Fondit i cili ka nënshkruar këtë kontratë, Shoqëria Administruese do të hapë një llogari personale.

Neni 3 Pagesa e Kontributeve

- Shuma e kontributit përcaktohet nga anëtarë, por jo më pak se 1,000 (një mijë) lekë në muaj.
- Në përputhje me legjislacionin në fuqi anëtar i merr përsipër të paguaj rregullisht kontributet për përfitim të pensionit privat. Anëtar i zgjedh frekuencën e pagesës së kontributeve e cila mund të jetë mujore, 3 mujore, 12 mujore ose si një shumë totale.
- Kontributet për pension privat paguhen nga anëtarë ose persona të tjerë në emër dhe për llogari të tij, në bankën "Banka Kombëtare Tregtare" sh.a., e cila është Banka Depozitare e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me të cilën Shoqëria Administruese ka lidhur marrëveshje.

Neni 4 Vlera Neto e Aktiveve dhe Vlera neto e aktiveve për kuotë

- Vlera totale e aktiveve të fondit të pensionit, në ditën e vlerësimit*, është shuma e vlerave të të gjitha llojeve të aktiveve të lejuara nga ligji dhe aktet nënligjore.
- Vlera neto e aktiveve të fondit të pensionit, në ditën e vlerësimit (t-1), rezulton nga diferenca ndërmjet vlerës totale të aktiveve të fondit të pensionit në ditën (t-1), me totalin e detyrimeve të fondit të pensionit të po asaj dite (t-1).
Pagesat në formë kontributi të bëra në llogarinë personale të anëtarit, si dhe aktivet e transferuara në fond, do të shndërrohen në kuota pensioni në ditën e mbërritjes së pagesës në llogarinë e fondit me çmimin e kuotës të ditës së mbërritjes së pagesës.
Kontributet e derdhura në fondin e pensionit për tu konvertuar në kuota, pjesëtohen me vlerën e aktiveve për kuotë të po asaj dite (t).
- Procedura e detajuar e konvertimit të kontributeve të paguara nga anëtarë në kuota përcaktohet në Prospektin e Fondit të hartuar nga shoqëria administruese.

- Çmimi i kuotës në ditën e vlerësimit (t-1) llogaritet duke pjesëtuar vlerën neto të aktiveve të fondit të pensionit të ditës (t-1) me numrin total të kuotave të fondit të pensionit të po asaj dite (t-1).
- Numri total i kuotave të fondit të pensionit, në ditën e vlerësimit (t-1), llogaritet duke i shtuar numrit të kuotave të pensionit të ditës (t-2), numrin e kuotave që fondi i pensionit emeton për anëtarët gjatë ditës (t-1) si dhe duke zbritur numrin e kuotave të shlyera nga fondi i pensionit në formën e pagesave për pension, tërheqjeve të parakohshme dhe të transferuara në një fond tjetër, në ditën (t-1).
- Kuotat e pensionit të emetuara dhe të tërhequra nga fondi i pensionit regjistrohen në llogaritë personale të anëtarëve të fondit në të njëjtën ditë të emetimit apo tërheqjes.

**Ditë vlerësimi nënkupton ditën "t" në të cilën bëhet përlogaritja e vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit mbështetur në të dhënat e mbylljes së një dite më parë "t-1".*

Neni 5 Kushtet për Përfitim

- Anëtar i fondit të pensionit, sipas zgjedhjes, ka të drejtë të marrë pagesën e menjëhershme të vlerës neto të aktiveve në llogarinë e vet ose pagesat periodike në formë pensioni që i përgjigjen kësaj vlerë kur:
 - mbush moshën e pensionit, të parashikuar me ligj, për sistemin e pensionit të detyrueshëm, që zbatohet për atë anëtar;
 - 5 vjet përpara se të mbushë moshën e pensionit, të parashikuar në shkronjën "a" të kësaj pike;
 - bëhet i paaftë për punë në mënyrë të përhershme dhe që vërtetohet, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Anëtar i fondit të pensionit gëzon të drejtën e përdorimit të vlerës neto të aktiveve në llogarinë e tij apo të një pjese të saj për blerjen e një kontrate të sigurimit të jetës në formë "anuiteti", të lëshuar nga një shoqëri e sigurimit të jetës, e licencuar nga Autoriteti.
- E drejta e pakushtëzuar e anëtarit të fondit për marrjen e pagesës së menjëhershme të të gjitha aktiveve neto në llogarinë e tij në fondin e pensionit apo e pagesave periodike në formë pensioni, pas plotësimit të kushteve, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të jetë e shkruar qartë në kontratën dhe prospektin e fondit të pensionit privat.

Neni 6 Llojet e Përfitimit

- Me plotësimin e kushteve për përfitim, anëtarë ka të drejtë të përfitojë nga kjo kontratë:
 - Pension Pleqërie
 - Pension të Parakohshëm
 - Pension Invaliditeti

Neni 7 Pagesa e Përfitimeve

- Pagesa e përfitimeve pas plotësimit të kushteve të përcaktuara në nenin 5 të kësaj kontrate, bëhet:
 - në mënyrë të menjëhershme, (pagesë e menjëhershme e plotë ose e pjesshme), pasi anëtarit i ka lindur e drejta e përfitimit të pensionit, shoqëria administruese siguron që vlera neto e aktiveve në llogarinë e anëtarit t'i paguhet këtij të fundit brenda 15 ditëve pune nga data e depozitimit të kërkesës nga anëtarë.
 - Pagesat në para, të kuotave që gjenden në llogarinë e anëtarit të fondit të pensionit, vlerësohen me çmimin e kuotës të ditës së depozitimit të kërkesës së anëtarit për tërheqje të menjëhershme;
 - në mënyrë periodike si pension, pavarësisht vlerës neto të aktiveve në llogarinë e tij, me plotësimin e kushteve të parashikuara në nenin 6, anëtarë i fondit mund të vendosë të marrë pagesa periodike mujore në formë pensioni të zgjatura në kohë, jo më pak se 2 vjet. Pagesave periodike mujore në para, të kuotave që gjenden në llogarinë individuale të anëtarit vlerësohen me çmimin e kuotës të ditës së njohjes së detyrimit të përcaktuar në kontratën e nënshkruar mes palëve. Për pagesat periodike, shoqëria

administruese llogarit dhe kryen transfertat mujore në bazë të një kontrate të veçantë për kushtet e pagesës së pensionit;

c) me përdorimin e vlerës neto të aktiveve të llogarisë së vet, apo të një pjese të tyre për blerjen e një kontrate të sigurimit të jetës në formë të përvitshme të lëshuar nga një shoqëri e sigurimit të jetës. Në rastin e transferimit të fondeve për blerjen e një kontrate sigurimi jete, shoqëria administruese njofton shoqërinë e sigurimit të jetës për kërkesën e anëtarit të fondit dhe merr një konfirmim nga kjo e fundit për blerjen e kontratës së sigurimit të jetës në formë “anuiteti”. Shoqëria e sigurimit të jetës që ofron shërbimin e pagesës së pensionit, përveç dispozitave të ligjit 76/2023, duhet të zbatojë gjithashtu dispozitat e ligjit që rregullojnë krijimin dhe veprimtarinë e shoqërive të sigurimit.

Shoqëria administruese transferon vlerën neto të aktiveve për blerjen e një kontrate të sigurimit të jetës tek shoqëria e sigurimit, brenda 15 ditëve pune nga data e depozitimit të kërkesës nga anëtarit;

d) me kombinimin e mënyrave të cituara në pikat a, b, dhe c më sipër.

2. Anëtar i fondit të pensionit mund të zgjedhë të marrë aktivet neto në llogarinë e tij të pensionit në formën e pagesave periodike të planifikuara sipas skedulit të përcaktuar në një kontratë të veçantë, që nënshkruhet midis anëtarit të fondit të pensionit dhe shoqërisë administruese.

3. Shoqëria administruese detyrohet të njoftojë anëtarin 3 muaj para lindjes së të drejtës për përdorimin e aktiveve neto në llogarinë e tij të pensionit, sipas afateve të përcaktuara në nenin 5, pika 1, shkronja b e kësaj kontrate.

4. Në rast të vdekjes së anëtarit të fondit përpara se të marrë pagesën e të gjithë aktiveve të veta, sipas nenit 57 të ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, aktivet në llogarinë e tij u shpërndahen trashëgimtarëve, në përputhje me dispozitat ligjore.

5. Pensioni paguhet në llogarinë bankare të anëtarit, sipas kontratës për pagesë periodike të pensionit, e lidhur për këtë qëllim nga shoqëria administruese me anëtarin në momentin e caktimit të përfitimit. Ndërmjet anëtarit të fondit dhe shoqërisë administruese lidhet një kontratë e veçantë për kushtet e pagesës së pensionit.

6. Pagesat e marra nga anëtar i fondit të pensionit në mënyrë të menjëhershme përpara afatit 2-vjeçar, të parashikuar në shkronjën “b” të pikës 1 të këtij neni, tatohen me normën në fuqi të tatimit sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat personale.

7. Shoqëria Administruese për çdo rast të vonuar në pagimin e shumave të menjëhershme apo të pagesave periodike, detyrohet t'i paguajë anëtarit të fondit interesin i cili llogaritet proporcionalisht: për çdo ditë vonese, duke filluar që nga dita e parë kur lind detyrimi për kryerjen e pagesës, deri në ditën kur kryhet pagesa; mbi shumën e pagesës së vonuar.

8. Në llogaritjen e interesit do të përdoret norma e interesit TRIBID, 12 mujore e kërkuar për pranimin e depozitave, e publikuar nga Banka e Shqipërisë, plus 5%.

9. Në rastet e pamundësisë për të tërhequr personalisht aktivet në llogarinë e tij për çdo arsye të dokumentuar, anëtar i ka të drejtë të autorizojë përfaqësuesin ligjor për të tërhequr të gjitha aktivet e grumbulluara në llogarinë e tij.

Neni 8

Të Drejtat dhe Detyrimet e Shoqërisë Administruese

Shoqëria Administruese është e detyruar që aktivet e anëtarit t'i administrojë në mënyrë profesionale në mbështetje të interesave të anëtarëve dhe për këtë:

a) Shoqëria Administruese hap për secilin anëtar një llogari individuale të veçantë, në të cilën regjistrohen të gjitha pagesat e kontributeve të bëra nga ai ose për llogari të tij, të gjitha interesat e grumbulluara në këtë llogari si rezultat i fitimit nga investimi, tërheqjet dhe transferimet.

Shoqëria Administruese konverton në kuotë pensioni kontributet e investuara në fond.

b) Shoqëria Administruese pas nënshkrimit të kontratës së anëtarësimit, pajis anëtarin me kartën personale të anëtarësisë me të cilën do të ketë mundësi të informohet mbi gjendjen e aktiveve në çdo kohë;

c) Shoqëria Administruese harton dokumentin “Vërtetim për gjendjen e llogarisë së pensionit të anëtarit të fondit” për çdo anëtar, ky dokument i dërgohet anëtarit të paktën 1 (një) herë në vit, në formë elektronike për të informuar anëtarin për aktivet, përfshirë vlerën neto të aktiveve në llogarinë e pensionit, datat e kontributeve, tërheqjet apo shlyerjet si dhe transferimet e aktiveve të bëra nga

ose në emër të anëtarit gjatë periudhës përkatëse dhe shndërrimin e këtyre kontributeve dhe aktiveve në kuota pensioni. Dokumenti përmban informacion të saktë, të përditësuar dhe i vihet në dispozicion çdo anëtar, pa pagesë, në formë elektronike. Krahas çdo informacioni në formë elektronike, anëtarëve u jepet edhe një kopje fizike me kërkesë të tyre, anëtar i fondit gjithashtu me anë të kartës personale të anëtarësisë do të ketë mundësi të informohet mbi gjendjen e aktiveve në çdo kohë.

Shoqëria Administruese është përgjegjëse për saktësinë e llogaritjes së vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit për çdo anëtar;

d) Shoqëria Administruese publikon në mënyrën dhe afate kohore të përcaktuara në ligj, raportet vjetore dhe pasqyrat financiare më të fundit, të ardhurat e fondit, vlerën e njësive të investimeve, normën e fitimit, çmimin e kuotës etj.;

e) Shoqëria Administruese informon në çdo moment anëtarët për ndryshimin në politikat e investimit si dhe për ndryshimet në veprimtarinë që ndikon në të ardhurat e tyre në mënyrë elektronike si dhe nëpërmjet faqes zyrtare dhe në informacionet individuale që u dërgohen sipas afateve të caktuara çdo anëtar i fondit.

f) Shoqëria Administruese ruan konfidencialitetin në lidhje me informacionin e dhënë nga anëtar, si dhe të dhënat e llogarisë së tij.

g) Shoqëria Administruese është e detyruar të raportojë informacionin sipas shkronjës “r” vetëm me kërkesë të organeve kompetente në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

h) Shoqëria Administruese kryen transferimin e aktiveve, mbështetur në kërkesën me shkrim të anëtarit, si në rastin e transferimit në një fond tjetër të administruar nga e njëjta Shoqëri Administruese, ashtu edhe në rastin e transferimit në një fond të administruar nga një tjetër Shoqëri Administruese.

Neni 9

Të Drejtat dhe Detyrimet e Anëtarit të Fondit

1. Anëtar i fondit paguan rregullisht kontributet në llogarinë e tij individuale vetë ose nga çdo person tjetër në emër dhe për llogari të tij.

2. Kontributet që ka paguar anëtar i në këtë fond pensioni, mund t'i jepen në çdo kohë përpara plotësimit të moshës, e të zgjidhjes së kontratës, pasi më parë, ky anëtar do të trajtohet sipas parashikimeve të neneve të kreut XIII të ligjit nr. 76/2023 “Për Fondet e Pensionit Privat”, për trajtimin fiskal të kontributeve si dhe kundrejt penaliteteve të përcaktuara në këtë kontratë.

3. Anëtar i ka të drejtë në çdo kohë të transferojë aktivet e tij nga një fond në një tjetër, të administruar nga e njëjta Shoqëri Administruese apo nga një Shoqëri tjetër Administruese.

4. Anëtar i humbet të drejtën t'i transferojë kontributet e paguara për pension në një fond tjetër pensioni pasi ka plotësuar kushtet për përfitim dhe ndërmjet anëtarit të fondit dhe Shoqërisë Administruese është lidhur kontrata e veçantë për kushtet e pagesës së pensionit.

5. Anëtar i vazhdon të mbetet anëtar i fondit edhe në rastet kur ka ndërprerë pagesën e kontributeve në llogarinë e tij personale, përveç rasteve kur anëtar i ka kërkuar me shkrim të tërhiqet nga anëtarësimi në fond.

6. Anëtar i fondit nuk penalizohet në rast se pushon së paguari kontribute në fond.

7. Anëtar i fondit mundet që pa e njoftuar paraprakisht Shoqërinë Administruese, të rrisë apo zvogëlojë masën e kontributit të tij dhe pa marrë parasysh nëse janë paguar rregullisht kontributet në llogarinë e tij personale.

8. Anëtar i pajiset me një dokument “Vërtetim për gjendjen e llogarisë së pensionit të anëtarit të fondit” si dëshmi e pronësisë së tij në fond. Dokumenti do t'i lëshohet çdo vit pas përfundimit të vitit kalendarik të anëtarësimit dhe sa herë të kërkohet nga anëtar. Vlera e njësive së përlllogaritjes së aktiveve mbahet në lekë dhe shprehet në lekë.

9. Anëtar i fondit të pensionit gëzon të drejtën e përdorimit të vlerës neto të aktiveve në llogarinë e tij apo të një pjese të saj për blerjen e një kontrate të sigurimit të jetës në formë “anuiteti”, të lëshuar nga një shoqëri e sigurimit të jetës, e licencuar nga Autoriteti.

Neni 10

Strategjia e Investimit

Politika e Investimit

1. Aktivët e fondit do të investohen me synim për të rritur kthimin nga investimi për anëtarët e tij, nëpërmjet administrimit të kujdesshëm dhe konservator të rrezikut të investimit. Portofoli i fondit do të përbëhet kryesisht nga tituj afatgjatë të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.
2. Politika e investimit paraqitet në Prospektin e fondit bashkëlidhur kësaj kontrate dhe e publikuar në faqen zyrtare të Shoqërisë Administruese.
3. Aktivët e fondit do të investohen sipas parimit të sigurisë afatgjatë dhe të një kthimi të përshtatshëm nga investimi, duke ruajtur një raport optimal mes rritjes së kursimeve për pension dhe riskut të marrë përsipër.
4. Aktivët e fondit do të investohen në instrumenta të sigurtë dhe ku një pjesë e të cilave do të jetë likuide.
5. Portofoli i fondit do të përbëhet kryesisht nga tituj afatgjatë (me maturim më të gjatë se një vit) të emetuara dhe/ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Pjesë përbërëse e portofolit do të jenë edhe titujt e borxhit afatshkurtër të emetuara dhe/ose garantuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë si dhe titujt të borxhit të emetuara nga bankat dhe institucione financiare jo bankare, që nuk janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar
6. Shpërndarja strategjike e aktiveve për Fondin paraqitet si më poshtë:

Tituj të Qeverisë Shqiptare – (99 % +/-1%)
Mjete Monetare, ekuivalentë të tyre & Depozita në banka të licencuara nga BSH – (1 % +/-1 %)
Në total vlera të titujve të borxhit, të emetuara nga bankat dhe institucione financiare jo bankare, që nuk janë pranuar për tregtim në një treg të rregulluar 5% </=

7. Investimi në aktive financiare shoqërohet gjithmonë me rrezik duke qenë se rreziku nuk mund të shmanget asnjëherë plotësisht. Çdo aktiv financiar përmban një kombinim midis rrezikut dhe normës së kthimit, ku sa më i lartë të jetë rreziku aq më e lartë mund të jetë norma e kthimit. Fondi i Pensionit është me kontribute të përcaktuara ku përfitimet nuk janë të garantuara, anëtarit pasi bie dakord me këtë kontratë dhe prospektin e Fondit, merr përsipër riskun e investimit të Fondit.

Neni 11

Depozitari

1. Shoqëria administruese ka lidhur marrëveshje për shërbimin e Depozitarit me bankën "Bankën Kombëtare Tregtare" sh.a me NUIS J62001011Q dhe me seli në adresën: Rruga e Vilave, Lundër 1, 1045, Tiranë, Shqipëri. Kjo bankë, në përputhje me ligjin nr.76/2023 "Për Fondet e Pensionit Privat" do të ofrojë shërbimet e kujdestarisë, të depozitimit dhe të besimit për aktivet e fondit.
2. Depozitari "Banka Kombëtare Tregtare" sh.a është një entitet ligjor i rregulluar, licencuar dhe mbikëqyrur nga Banka e Shqipërisë sipas licencës me nr. 6/1998, datë 11.01.1999 dhe licencën si Depozitar i Fondit të Pensioneve nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, me nr. 4 datë 21.12.2015.
3. Depozitari do të jetë përgjegjës për ruajtjen e aktiveve në fond. Depozitari kontrollon administrimin e aktiveve të fondit nga Shoqëria Administruese në përputhje me dispozitat e kontratës, prospektin si dhe të legjisllacionit në fuqi.
4. Depozitari është një entitet tërësisht i pavarur nga Shoqëria Administruese dhe çdo palë tjetër e lidhur me të, i cili siguron që të gjitha të ardhurat e fondit do të shpërndahen në përputhje me ligjin dhe kontratën.

Neni 12

Transferimi i Aktiveve

1. Anëtar i fondit të pensionit ka të drejtë të transferojë aktivet në llogarinë e tij në një fond tjetër pensioni, të administruar nga e njëjta

Shoqëri Administruese ose nga një Shoqëri Administruese tjetër. Transferimi i aktiveve në një fond tjetër pensioni të administruar nga e njëjta Shoqëri Administruese nuk shoqërohet me komision transferimi.

2. Në rastin e transferimit të aktiveve të anëtarit në një Shoqëri tjetër Administruese, Shoqëria Administruese me marrjen e kërkesës me shkrim nga anëtarit për të transferuar aktivet njofton brenda 5 ditëve pune Shoqërinë tjetër Administruese për kërkesën e anëtarit për transferimin e aktiveve.
3. Shoqëria Administruese ekzekuton transferimin e aktiveve në llogari brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së konfirmimit të Shoqërisë Administruese tjetër.
4. Në rastin e transferimit brenda të njëjtës Shoqëri Administruese, transferimi ekzekutohet brenda 5 ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës nga anëtarit.
5. Brenda 5 ditëve pune nga data e transferimit të llogarisë, Shoqëria Administruese informon anëtarin për ekzekutimin e transferimit, vlerën totale neto të aktiveve të transferuara, përfshirë kthimin nga investimi, si dhe detyrimet e zbritura.

Neni 13

Tarifat e Shoqërisë Administruese

1. Shoqëria Administruese në zbatim të ligjit nr.76/2023, "Për Fondet e Pensionit Privat" si dhe Rregulloret të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, "Për Penalitetet e Zbatuara në Rastin e Tërheqjes së Parakohshme nga Fondi i Pensionit Privat", do të zbatojë këto tarifa:

- a) për komisionin vjetor të administrimit të fondit të pensionit 1.5% (një pikë pesë përqind) në vit të vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit dhe kjo është tarifa e vetme që i mbahet Fondit të Pensionit.
- b) për transferimin e aktiveve të anëtarit nga fondi i pensionit ekzistues në një fond të ri pensioni të administruar nga një Shoqëri tjetër Administruese, do të aplikohet komisioni i transferimit i cili do të jetë 0.5% (zero pikë pesë përqind) e shumës së transferuar;
- c) tarifa e administrimit të fondit do të'i ngarkohet aktiveve të fondit në fund të çdo dite dhe do të mbahet në fund të çdo muaji si shumë e vlerës ditore për atë muaj;
- d) për tërheqjet e parakohshme të pensionit anëtarët e fondit të pensionit do të paguajnë penalitete si më poshtë:
 - 5 % të aktiveve të tërhequra pas 20 vitesh nga data e pagesës së kontributit të parë;
 - 10 % të aktiveve të tërhequra pas 10 deri 20 vite nga data e pagesës së kontributit të parë;
 - 15 % të aktiveve të tërhequra pas 5 deri 10 vite nga data e pagesës së kontributit të parë;
 - 20 % të aktiveve të tërhequra deri 5 vite nga data e pagesës së parë të kontributeve.

2. Në rastin e vdekjes së anëtarit penalteti i tërheqjes së parakohshme nuk aplikohet.
3. Përveç tarifave të përmendura më lart, anëtarit i Fondit të Pensionit është i detyruar që të kompensojë Shoqërinë Administruese për të gjitha shërbimet shtesë të ofruara sipas kërkesës së anëtarit (si për shembull: shpenzime të ndryshme bankare, shpenzimet postare, etj.)
4. Çdo rritje e komisioneve dhe tarifave të zbatuara nga Shoqëria Administruese, brenda kufijve të përcaktuar me ligj, u njoftohet anëtarëve, të paktën, 6 (gjashtë) muaj përpara se ato të hyjnë në fuqi.

Neni 14

Trajtimi Fiskal

1. Trajtimi fiskal i kontributeve të paguara nga Anëtarit në Fond si dhe pagesave të kryera nga Fondi do të jetë sipas dispozitave ligjore në fuqi për tatimin mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë.
2. Në zbatim të nenit 156 të ligjit nr.76/2023, "Për Fondet e Pensionit Privat", anëtarit i fondit ka këto lehtësira fiskale:

a) Kontributi i bërë nga çdo anëtar i një fondi pensioni zbritet nga të ardhurat personale të tij, për efekt tatimi. Kufiri maksimal për lehtësira tatimore për kontributet vjetore është deri në nivelin e pagës minimale të miratuar në shkallë vendi;

b) Kthimi i investimit, përfshirë fitimet nga kapitali prej investimeve të kryera me aktivet e fondit të pensionit nuk i nënshtrohen tatimit, as për vetë fondin e pensionit dhe as për Shoqërinë Administruese.

3. Pagesat e marra nga anëtar i fondit të pensionit në mënyrë periodike mujore tatohen vetëm për kthimin nga investimi, me normën në fuqi të tatimit mbi të ardhurat personale.

4. Pagesat e marra nga anëtar i fondit të pensionit në mënyrë të menjëhershme, përpara afatit 2-vjeçar të marrjes së tyre në mënyrë periodike mujore, siç parashikohet në ligj, tatohen me normën në fuqi të tatimit mbi të ardhurat personale për vlerën e plotë të aktiveve të tërhequra, përfshirë kontributet.

Neni 15 **Kohëzgjatja e Kontratës**

1. Kjo kontratë lidhet për një afat të pacaktuar dhe do të sjellë pasoja ligjore vetëm pasi të jetë bërë pagesa e parë e kontributit.

2. Kontrata përfundon:

- a) Kur të gjitha aktivet e anëtarit janë transferuar në një fond pensioni tjetër;
- b) Në rastin e tërheqjes së parakohshme;
- c) Në rastin e vdekjes së anëtarit.

3. Anëtar i fondit mund të përfitojë të drejtën për dalje jashtë përcaktimit më sipër nga anëtarësimi në fond, në rast të shfaqjes së paafetësisë për punë në mënyrë të përhershme dhe që vërtetohet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Anëtar i fondit brenda 30 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së pagesës së kontributit të parë në llogarinë e fondit mund të zgjidhë pa penalitete kontratën e anëtarësimit në fond, pa përmendur arsye të veçanta, duke njoftuar me shkrim ose postë elektronike Shoqërinë Administruese. Shoqëria Administruese duhet të bëjë pagesën brenda 5 ditëve pune nga dita e marrjes së kërkesës me shkrim të anëtarit.

5. Nëse anëtar i fondit plotëson kushtet për marrjen e pagesës së pensionit dhe ka zgjedhur marrjen e pagesës nëpërmjet Shoqërisë Administruese, anëtarësia e tij në fond do të përfundojë vetëm kur të jenë shlyer dhe kuotat e fundit në llogarinë e anëtarit në fondin e pensionit në përputhje me dispozitat e kontratës në fjalë.

Neni 16 **Zgjidhja e Kontratës**

Nëse secila nga palët nënshkruese të kësaj kontrate kërkon të tërhiqet nga zbatimi i saj, atëherë ajo është e detyruar të njoftojë palën tjetër brenda një afati jo më pak se tre muaj nga data që ka vendosur të tërhiqet.

Neni 17 **Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve që mund të lindin nga zbatimi i kësaj kontrate bëhet me mirëkuptim midis palëve, ose në rast të kundërt, çdo palë ka të drejtë t'i drejtohet gjykatës së rrethit gjyqësor.

Neni 18 **Sanksione**

1. Anëtar i fondit merr njoftim paraprakisht për legjislacionin në fuqi lidhur me këtë kontratë dhe prospektin e fondit dhe e nënshkruan kontratën me vullnet të plotë e të lirë.

2. Anëtar i fondit mban përgjegjësi dhe detyrime ligjore të përcaktuara në rast të shkeljes së detyrimeve që ka kjo kontratë, deklarimeve të rremë apo paraqitjes së dokumentacionit të pavërtetë.

3. Shoqëria Administruese është përgjegjëse para anëtarit për dëmet e shkaktuara ose për përmbytjen jo në mënyrën e duhur të detyrimeve të saj, të përcaktuara sipas ligjit, statutit dhe në këtë kontratë.

4. Shoqëria administruese nuk është përgjegjëse, nëse dështimi ose përmbytja në mënyrën jo të duhur të angazhimeve është rezultat i rrethanave, në të cilat Shoqëria Administruese nuk mund të ndikojë.

Neni 19 **Kufizimet e Sanksioneve dhe Klauzola Përrjashtuese**

Pavarësisht dispozitave të tjera të kësaj kontrate, kjo kontratë nuk është në kundërshtim me asnjë sanksion ekonomik, tregtar ose financiar dhe/apo embargo të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KB), të Bashkimit Evropian (BE), ose ndonjë ligji apo legjislacioni vendor i aplikueshëm për palët e kësaj kontrate. Kjo klauzolë gjithashtu është e aplikueshme edhe për sanksionet ekonomike, tregtare ose financiare dhe/ose embargo të lëshuara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës ose vendeve të tjera, për aq sa nuk bien ndesh me legjislacionin e Bashkimit Evropian (BE) ose legjislacionin vendor.

Neni 20 **Dispozita të Përgjithshme**

1. Për çdo parashikim që nuk del qartë nga kjo kontratë, palët u referohen prospektit dhe legjislacionit në fuqi.

2. Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj kontrate mund të arrihen vetëm me miratimin e dy palëve kontraktuese, pasi më parë të jetë marrë miratimi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

3. Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga të dyja palët, pasi anëtar i është vënë në dijeni për të gjitha kushtet e referuara në prospekt dhe rregulloret e shoqërisë, i ka pranuar dhe angazhohet në zbatimin e tyre. Prospekti i bashkëlidhet kontratës së fondit të pensionit

